

BLERINA HARIZAJ

METRIKA PERSIANE NË POEZINË E VEXHI BUHARASË

Në historinë e zhvillimit të saj, letërsia shqipe sikundër edhe letërsitë e tjera botërore, ka qenë e hapur për marrëdhënie me sistemet e tjera letrare. Ajo, si një letërsi në zhvillim, ka pasur nevojë që të pasurojë vazhdimisht veten e saj, duke huazuar prej sistemeve burimore (letërsive qendrore) modele poetike, tema, motive dhe figura letrare.

Por duhet thënë se ajo ka ruajtur gjithnjë identitetin e vet origjinal, edhe pse këto elemente i ka bërë pjesë të sistemit të saj letrar. Pa u zgjatur, shembulli tipik i kësaj ç'ka thamë është edhe orientalisti, poeti, studiuesi dhe përkthyesi i njohur i klasikëve të mëdhenj persianë, Vexhi Buharaja. Fakt është se ai e projektoi veten më shumë në fushën e kërkimit, studimit dhe përkthimit, se në poezi. Në trashëgiminë e tij letrare radhiten pak poezi, vetëm ato që i përkasin periudhës së viteve 1940-1943, poezi të cilat Buharaja i botonte kryesisht në periodikun e asaj kohe, dhe nuk i shohim si botim më vete.

Vite më pas do ishte vetë miku i tij Ahmet Kondo që do t'i përmbledhte në botimin monografik "Vexhi Buharaja: njeriu, poeti, dijetari 1920-1987", kushtuar kësaj figure. "Megjithatë - thotë Ahmed Kondo, - poezia origjinale e këtij poeti, edhe pse e pakët në sasi, ka lënë gjurmën e vet të ndritur, si perlë, në historinë poezisë kombëtare shqiptare"¹. Ndërsa, sipas Yzedin Himës, "V. Buharaja ka lënë të shpërndara në revistat dhe gazetatat e harkut kohor 1940-1945 rreth 15 poezi dhe një prozë poetike. Pas viteve dyzetë ai nuk shkroi më letërsi artistike, por u mor me përkthime e studime"². I këtij mendimi është edhe Ahmet Kondo i cili thotë se, "në vitin 1940 ai filloi të përqëndrojë vëmendjen në sferën e gjerë të kulturës së ndritur orientale turke-arabe-persiane, që, siç dihet, në vitet e mëpastajme, do ta bënte të shquhej si orientalist në drejtim të letërsisë artistike persiane dhe në degën e osmanistikës, ku ai dha prova të formimit

¹ A. Kondo, *Vexhi Buharaja njeriu, poeti, dijetari 1920-1987*, "Uegen", Berat, 1995, f. 10.

² Y. Hima, *Vexhi Buharaja pa mite e mjegull*, AIITC, Tiranë, 2008, f. 116.

të personalitetit si shqipërues dhe përkthyes i shquar me vlera të veçanta, që pasurojnë fondin e kulturës sonë”³.

Për kontributin e Vexhi Buharasë në fushën e orientalistikës flet edhe akademiku Jorgo Bullo i cili shprehet: “ka qenë një guxim i madh krijues i Vexhi Buharasë të sillte shqip jo vetëm “Tehajjulat” e Naimit, jo vetëm “Gjylistanin dhe Bostanin” e Saadiut, por edhe këtë epos madhështor (e ka fjalën për Shahnamenë - shënimi im) të një epoke të largët në një gjuhë arkaike dhe për kohën kur është shkruar, por të larmishme, me një figuracion kompleks, me një lakonizëm dhe ekspresivitet të veçantë me një rritëm energjik rrëfimi, Buharaja ia ka dalë të bëjë të këndojë shqip Firdeusin”⁴. Po të vërejmë me kujdes poezitë e Buharasë, ato projektohen si një e tërë, që i bashkon një ide e vetme “dashuria për jetën”. Buharaja krijoi një poezi që tërhoqi vëmendjen”⁵. Por në të ai synon të shfaqë gjithnjë identitetin poetik të tij, edhe kur bëhet fjalë për prani të temave, motiveve apo figurave kryesisht të huazuara nga letërsia orientale. “Në poezinë e Buharasë ndjehet një shkrirje e natyrshme mes dy prirjeve poetike: asaj romantike dhe lehtësisht asaj simboliste, të dyja të konfiguruar në një lirikë të mirëfilltë dhe plot shenja të individualitetit letrar dhe intelektual”⁶. Kur flasim për një ndikim të poezisë orientale në krijimtarinë e tij letrare, është e justifikueshme, pasi kemi parasysh që Buharaja ishte një njohës shumë i mirë i gjuhëve dhe i letërsisë orientale, veçanërisht asaj persiane. Kjo edhe për faktin se ai përktheu dhe shqipëroi poetët e mëdhenj persianë, Saadi Shiraz, Hafizi, Firdeusi, etj. Studiuesi Yzedin Hima shkruan: “V. Buharaja që shëtiti në kopshtet dhe lulishtet e begata të poezisë orientale, jashtë çdo dyshimi mori dhe ruajti nga ajo poezi standartet e larta të artit poetik. Tek ajo ndeshim edhe elementë dhe mjete të përdorura nga poezia më e mirë orientale. Ndikimi nga poetika orientale te poetika e Buharasë është një ndikim i tërthortë, në atë që quhet nënvetdije.”⁷ Megjithatë do të përqendrohemi vetëm te një element i formës, metrika, pra vargu i përdorur nga Buharaja.

³ Shih *Vexhi Buharaja njeriu, poeti, dijetari 1920-1987*, “Uegen”, Berat, 1995, f. 10.

⁴ J. Bullo, *Vexhi buharaja na sjell një epos madhështor të një epoke të largët*, Republika, 2010/ 98-123, Tiranë, f. 17.

⁵ Shih *Vexhi Buharaja pa mite e mjegull*, f. 22.

⁶ B. Shatro, *Vexhi Buharaja, mistike dhe logos në kulturën shqiptare*, Art dhe Trashëgimi, 2011/1, Berat, f. 79.

⁷ Y. Hima, *Vexhi Buharaja pa mite e mjegull*, AIITC, Tiranë, 2008, f. 147, 151.

Dhe siç shohim në poezitë e tij kemi një ndikim të metrikës persiane, duke përdorur lloje poetike* të tipit, *masnavi* (mesnevi), *katren* (rubai), *kaside*, *ferd* (fird) apo edhe *kat'e*, që hyjnë si një risi në fushën e studimeve tona letrare. Metodatat që kam ndjekur janë: metoda e analizë-sintezës dhe ajo krahasuese për t'i ardhur në ndihmë studimit të vargut poetik. Metoda e analizë-sintezës ka të bëjë me mënyrën e përfshirjes së zhanreve poetike me burim të huaj në tekstin buharjan, dhe përdorimit të tyre nga ana e poetit, gjithnjë në funksion të kontekstit. Dhe kjo metodë apo tjetra do ishte e plotë me mbështetjen teorike, që e përforcon akoma më shumë studimin tonë, kur bëhet fjalë për rastin e një poeti shqiptar. Ndërkaq metoda krahasuese përdoret atëherë kur kemi të bëjmë me një ndikim të dukshëm apo të tërthortë, në huazimin në tekstin tonë të llojeve poetike nga letërsia burimore apo qendrore (letërsitë e zhvilluara). Dhe krahasimi në të tilla raste është i paevitueshëm, pasi përkon me vetë qëllimin e studimit tonë. Siç është qasja e tekstit të Vexhi Buharasë me disa prej veprave të poetëve persianë në aspektin metrik, parë edhe në dritën e prozodisë persiane. Gjithashtu mbetet për t'u parë edhe aftësia poetike e Buharasë për t'i sjellë këto zhanre poetike në format e tyre origjinale. Në rastin e Buharasë unë i mëshoj idesë se përdorimi i modeleve të ndryshme poetike me burim persian nga ana e poetit mund të jetë edhe një reminishencë (e pavetëdijshme) që buron nga njohja e thellë e kulturës dhe letërsisë orientale. Në këtë kontekst, lirshëm mund të themi se llojet poetike, si: *masnavi* (mesnavi), *fard*, *kaside*, *kat'e* (qitah) apo *katreni* i përgjigjen më së miri shpirtit poetik dhe mendimeve filozofike të Vexhi Buharasë. Përdorimi i tyre nga Buharaja tregon përpjekjen e tij për të imituar poetët persianë, pavarësisht që, në poezitë, ai na shfaq individualitetin e tij krijues. Për të kuptuar në thelb këto modele poetike duhet të shohim së pari se si është ndërtuar sistemi prozodik persian, i cili ka huazuar elemente nga prozodia arabe. Për këtë i referohemi disa studiuesve të ndryshëm, që janë marrë me çështjet e prozodisë arabo-persiane. Studiuesi Elias John Gibb thotë: “në sistemin arab gjejmë një tipar dallues që është *monorima*: një rimë e vetme në fillim të poemës dhe që nuk ka rëndësi sesa e gjatë është ajo. Uniteti me anë të të cilit është ndërtuar skema arabe quhet *Misra*”* (e cila përkthehet si ‘*Hemistich*’*)”.

* Shënim: Në prozodinë persiane quhen ndryshe edhe kompozicione poetike.

* Shënim: *Misra* - radhë

* Shënim: *Hemistich* - gjysmëvargu

Ajo është një radhë e vetme e vargut shkruar në një prej metrave tradicionale, që pasohet nga një tjetër radhë (varg) po me të njëjtin metër, që quhet distik ose çift (vargjesh - shënimi im). Beyt* (bait) zakonisht përkthehet si “Distik” ose “Çift vargjesh” (Couplet) që konsiston në dy *misra*’ (radhë vargjesh) me të njëjtin metër, në të cilat misrat mund të rimojnë ose jo bashkë. Kur gjysmëvargjet rimojnë (hemistik) Bayt (Bait-vargu) quhet “*Musarra*” ose “*i Rimuar*”⁸. Ndërsa sipas studiuesit të historisë iraniane, Jan Rypka, “poezinë ose “letërsinë metrike” e përcaktojnë disa elementë të jashtëm: madhësia e rrokjeve sipas gjatësisë, që është prozodia sasiore (kuantitative)*dhe rima*. Uniteti i poemës quhet *distik (bayt)* që ndahet në dy gjysmëvargjesh (semi-distich) (*misra*’) që i nënshtrohen rregullave të prozodisë apo numrit të rrokjeve dhe lidhen nga një mendim. Duhet theksuar se në disa raste ato i bashkon një mendim apo një argument i fshehur. Rrallë herë mund të grupohen gramatikisht bashkë një numër mendimesh që mbulojnë dy ose më shumë bayts (baits). Çdo distik (dy vargësh) është i pavarur në vetvete”⁹.

Në çdo formë poetike metri dhe gjatësia e të gjithë gjysmëvargjeve (hemistikë) janë të njëjtë. Përmbajtja e rimës në fund të çdo vargu varet nga lloji i formës poetike.

Në shumë raste, kur poeti përsërit fjalën ose disa fjalë pas rimës në çdo varg quhet radif (refren). Mbi të gjitha në vargun persian ajo çfarë është e rëndësishme është që vargu duhet të jetë i pavarur nga kuptimi¹⁰. Në rastin e Vexhi Buharasë, prania e llojeve të ndryshme poetike me burim oriental në poezitë e tij është tregues i qartë i ndikimit të metrikës arabe dhe asaj persiane. Por një dukuri që vihet re te krijimet e Buharasë është përzierja e këtyre formave letrare brenda një poezie apo poeme, një dukuri

* Shënim: Bayt - varg

⁸ E. J. W. Gibb, *A history of Ottoman poetry 1875-1901*, vol. 1, London Luzac, Toronto, 1900, f. 88-89.

* Shënim: Për poezinë e re persiane në të cilën shohim një zhvillim të saj nga aspekti metrik dhe rimik, ku dallohen metrat sasiore dhe një rimë e përbashkët në fund të çdo bajti (vargu), shih *Encyclopedia of Arabic Literature*, Edited by Julie Scott Meisami, Paul Starkey, Vol. 2, Routledge, 1998, f. 601.

* Shënim: Rima në poezinë persiane ndiqet nga radif (refren) i cili i jep gjatësi vargut të rimuar për këtë shih Jan Rypka, *History of iranian literature*, f. 93.

⁹ J. Rypka, *History of iranian literature*, D. Reidel Publishing Company, Dordrecht-Holland, 1968, f. 91.

¹⁰ Y. Matini, *The different aspects of Islamic culture*, Culture and Learning Islam, Vol. 5, Unesco 2003, f. 33.

e cila është e njohur edhe në letërsinë persiane, dhe këtë na e pohon studiuesi Elwell-Sutton.

Megjithatë, kjo nuk do të thotë se në letërsinë shqipe nuk e hasim një gjë të tillë, madje në ditët e sotme është një fenomen që ndodh rëndom, ku poetë të ndryshëm tentojnë që, brenda një krijimi, të përdorin lloje të ndryshme letrare. Ndryshe nga poetët e tjerë shqiptarë, që kemi parë deri tani si: Naim Frashëri, Baba Ali Tomorri apo edhe bejtexhinjtë, që në krijimet e tyre kanë përdorur zhanre letrare të tipit masnavi, kaside, gazele, rubai (katërvargësh), nefese apo edhe mersija (marthiya), poeti Buharaja përdor edhe llojin poetik *ferd* (që qëndron si një njësi më vete). Nën ndikimin e këtij zhanri poetik ai do krijonte poezinë “Se je lule që s’humbe”, e cila hap edhe vëllimin me poezi origjinale (1940-43) të Buharasë. Në fakt shohim një përpjekje të poetit për ta sjellë këtë zhanër me burim oriental në formën e tij origjinale. Dhe gjëja që na shtyn të pranojmë këtë fakt është skema metrike e *Fard-it*. Për ta kuptuar në thelb *fard-in*, i referohemi studiuesit Gibb, i cili thotë se, “kur dy rreshta nuk rimojnë njëri me tjetrin në një varg të pavarur quhet *ferd* ose *mufred*”, të dyja këto nënkuptojnë një njësi të vetme”¹¹.

Ndërsa studiuesi Francis Gladwin e përkufizon kështu: “*fird* është një distik i vetëm ose *Biet* (*bayt*) në të cilin gjysmëvargjet mund të rimojnë ose jo njëri me tjetrin sipas dëshirës së poetit”¹². Ndërkaq për studiuesin tjetër Jan Rypka, “ekzistojnë vargje të ndara (*fard*) *aa* ose *ab* që përmbajnë momente brilante të asaj pjese të poetit, i cili e ka të pamundur që t’i shfaqë në një mënyrë tjetër”¹³. Për të vërtetuar këtë mjafton të citojmë vargun e parë dhe të dytë të poezisë “Se je lule që s’humbe”: “*lule, jetën kush ta fali? / kaq e bukur si ke mbirë / je mbi shoqe, ndaj të themë / të ka vënë Dor’ e lirë*”¹⁴. Nisur nga struktura metrike e tyre, lirshëm mund të themi se Buharaja ka përdorur modelin poetik *fard*, pasi vargjet nuk rimojnë njëri me tjetrin dhe janë ndërtuar sipas skemës metrike *ab*, por

* Shënim: Mufred është poezia e cila ka një varg ose një strukturë pak të përdorur poeti i Shiraz. Shih për këtë *Historia e letërsisë perse*, A. Tamimdari, f. 213.

¹¹ E. J. W. Gibb, *A history of Ottoman poetry 1875-1901*, vol. 1, London Luzac, Toronto, 1900, f. 79.

¹² F. Gladwin, *Dissertations on Rhetoric, prosody and rhyme of the Persians*, Calcutta Printed, 1801, f. 4.

¹³ J. Rypka, *History of iranian literature*, D. Reidel Publishing Company, Dordrecht-Holland, 1968, f. 96.

¹⁴ A. Kondo, *Vexhi Buharaja; njeriu, poeti dhe diejtari 1920-1987* SHB “Uegen”, Berat, 1995, f. 29.

elementi që na e përforcon më shumë idenë se këto vargje janë *ferd* është se ato i shohim të ndara veças, të cilat shprehin atë mendim poetik të cilin poeti e ka të pamundur ta shprehë në një mënyrë tjetër. Ndaj për poetin Buharaja, *fard* është forma poetike që i përgjigjet më së miri shpirtit të tij poetik apo edhe mendimeve të tij filozofiko-fetare. Përdorimi i këtyre llojeve poetike me burim të huaj nga poetët shqiptarë mund të jetë rastësor ose i qëllimshëm, nisur edhe nga zhvillimet brenda një sistemi të caktuar letrar. Kohërent në këtë arsyetim, Itamar Zohar thotë se “përzgjedhja e elementeve (modele, zhanre, figura etj.) bëhet në pajtim me interesat dhe strukturën e letërsisë target, dhe janë nevojat ato që përcaktojnë dhe prijnë përzgjedhjen e tyre”¹⁵. Ndërsa për studiuesin tjetër Dhimitër Shuteriqi, “disa strofa janë përdorur në shqipet rastësisht ose janë shumë të njohura në gjuhë të tjera”¹⁶.

Në rastin e poetit tonë nuk ka vend ideja se ky lloj poetik është përdorur rastësisht, pasi në vetëdijen letrare të poetit gjejmë gjurmë të letërsisë apo kulturës orientale, nisur edhe nga njohja e thellë që ai ka pasur për këtë kulturë. Në këtë mënyrë asgjë nuk është rastësore, pasi poeti ka qenë i vetëdijshëm në përdorimin jo vetëm të kësaj forme poetike por edhe të tjerave me burim oriental, duke qenë se ato i janë përgjigjur më mirë kërkesave të tij poetike por edhe shpirtërore. Poezi të shkruara në këtë zhanër poetik i shohim edhe te poetët persianë si: Rumi, Rudaku etj., “*dy lloj kallamash ka në fushë, sheher / njeri është fyl dhe tjetri plot sheqer*”¹⁷. *Ti posi zjarri, ngadhnjim lakmon / posi peshore, drejtësi kërkon*.¹⁸ Një tjetër formë poetike që përdor Vexhi Buharaja në poezitë e tij është edhe katërvargëshi, të cilin e shohim që në poezinë e parë, “Se je lule që s’humbe”. Ndaj përveç llojit poetik *Fard* (distik) ai përdor edhe katërvargëshin (katrenin) i cili është forma e rubaisë iraniane. Në letërsinë persiane dhe jo vetëm, katërvargëshi është forma e rubaisë, skema metrike origjinale e së cilës është aaba ose aaaa.

Themi që Buharaja përdor edhe katrenin persian (rubai), pasi katërvargëshat e përdorur prej tij qëndrojnë si poezi më vete, duke qenë të ndarë njëri nga tjetri, dhe mbartin një frymë të theksuar filozofike, një cilësi kjo, e vetë këtij lloji poetik. Fakt është se poeti Buharaja nuk e sjell

¹⁵ I. Zohar, *Papers in historical poetics*, Tel Aviv, 1978, f. 51-52.

¹⁶ Dh. Shuteriqi, *Metrika shqipe për shkollat e mesme dhe të nalta*, Enti i botimeve të teksteve, Prishtinë, 1968, f. 70.

¹⁷ M. Xh. Rumi, “*Masnavi Ma’navi*”, Tiranë, 2007, f. 146.

¹⁸ Pjesë e shkëputur nga poezitë dyvargëshe (distikë) në formë fard-i të Rudakiut, shih *Antologjia e poezisë persiane*, Botimi II, Tiranë, 2011, f. 72.

rubainë në formën e saj origjinale, pasi nuk i përmbahet skemës metrike të saj, për të cilën folëm më lart. Ai përdor kryesisht skemat metrike të katrenit klasik, abcb, abab, aabb, abba, dhe themi se këto poezi të ndërtuara me këto skema qëndrojnë më vete duke u sjellë edhe si epigrame, një formë tjetër kjo e rubaisë persiane.

Orientalistja e njohur Annamaria Schimmel thotë: “rubaia mund të quhet edhe epigram, sepse është e shkurtër dhe esenciale që ngjason në shumë aspekte edhe me poezinë folklorike tradicionale perse të periudhës pre-islamike”¹⁹. Ndërkohë që studiuesja tjetër Loraine shprehet se, “rubaia është ideale për përdorimet tipike si: epigramatike, filozofike, gnomike për miniaturën erotike si edhe atë anakreontike”²⁰. Në formë epigrami (rubaisë) janë poezitë “Inxhi” dhe “Se je lule që s’humbet”, të cilat trajtojnë një temë të caktuar dhe rimojnë sipas skemës metrike ABAB, ABCB. Në rastin e parë kemi një alternim të rimave femërore me ato mashkullore, ku rima kryesuese A është një rimë femër.

Katreni me këtë skemë rimimi quhet ndryshe katren i hapur²¹. Ndërsa në poezinë e dytë, katërvargëshi ndërtohet sipas skemës metrike abcb, që ndryshe quhet edhe katërvargësh me rimë të kryqëzuar. Vargu A dhe C nuk rimojnë njëri me tjetrin, ndërsa vargu i dytë dhe i katërt rimojnë së bashku. Ky metër përdoret për baladat, elegjitë dhe për katërvargëshin e tipit heroik (për vepra të karakterit epiko-heroik)²².

Inxhi thashë, do qëmtoj nga deti A (9 rrokje)
Dhe lule do mbledh nga çdo fushë B (9 rrokje)
Dhuratë e fisme poeti A (9 rrokje)
Rruazare t'i shkoja në gushë.²³ B (10 rrokje)

Të pëlqeu shpirti vetë, A (8 rrokje)
Nënë e motër, ndaj të tha: B (7 rrokje)

¹⁹ A. Schimmel, *A two colored brocade, the imagery of persian poetry*, University of North Carolina Press, Chapell Hill and London, 1992, f. 28-29.

²⁰ M.B.Loraine, *Dissertations of prosody and rhyme in classical Arabic and persian*, Seattle, USA, 1973, f. 55.

²¹ A. Cuddon, *The penguin dictionary of literary terms and literary theory*, Penguin group, England, 1999, f. 720.

²² S. Cushman, C. Cavanagah, J. Ramazani. P. Rouzer, R. Greene, *Princeton encyclopedia of poetry and poetics*, f. 1138.

²³ A. Kondo, *Vexhi Buharaja: njeriu, poeti dhe diejtari 1920-1987* SHB “Uegen”, Berat, 1995, f. 51.

Te ti gjeti ëmbëlsinë C (8 rrokje)
Zemra ime, kur të pa²⁴ B (7 rrokje)

Në rastin e katrenit (katërvargëshit) poeti Buharaja nuk respekton skemën ritmike origjinale të rubaisë, pavarësisht se në disa krijime sillet si e tillë duke qëndruar si poemë më vete nisur nga përmbajtja apo fryma që ajo përcjell. Në këtë kontekst, për të kuptuar thelbin e rubaisë, i referohemi interpretimeve nga studiues të ndryshëm që kanë bërë lidhur me të. Studiuesi Gibb e përkufizon kështu, rubaia* (në shumës ruba'ijjat - ruba'iyat) ose katren është një poemë e shkurtër me katër vargje, ku vargu i parë, i dytë dhe i katërt rimojnë njëri me tjetrin, ndërsa vargu i tretë është i bardhë (ose i zbrazët) dhe nuk rimon me tre të tjerët. Rima e dy vargjeve të para që duket sikur humbet në shfaqjen e rimës rikthehet në vargun e katërt dhe e mbyll poemën e vogël duke na kënaqur estetikisht. Çdo rubaia është unike në vetvete dhe nuk ka lidhje me asnjë rubai tjetër në ide dhe përmbajtje. Sipas Gibb “rubaia mund të trajtojë çdo subjekt, duke u bërë një model sa më efektiv”²⁵. Për studiuesin italian Alessandro Bausani, “kuartina klasike që në kuptimin teknik njihet si rubaia (katërvargësh) ose dubajt (dyvargësh), apo ndonjëherë si tarane (melodi), identifikohet nga ana metrike me çfarëdo gazali apo kaside, nga dy vargjet e para. Vargu i parë rimon me dy vargjet që kanë të njëjtën rimë me të parën, duke bërë që kuartina të ketë skemën ritmike a-a-b-a. Kuartina u bë instrumenti i shprehjes së mistikëve²⁶. Duhet thënë se krijimi i parë i rubaisë mban emrin e poetit Rudaki, dhe poetë të tjerë pas tij si: Sinai, Attari, Rumi dhe Omar Khajjami të cilët krijuan rubaia me subjekte të ndryshme dhe me metër 13 rrokësh apo edhe më shumë.

Në qiell vetëtima shndrit, pastaj gjëmon e bubullin, A (17 rrokje)
Si klithm' e nënës që humb vajzën, kur vdekja bukurin' ia fshin! A (17 rrokje)
Mëndafsh i gjelbër i mbulon t'ergjendat degë të një shëlgju, B (17 rrokje)

²⁴ Shih V. Buharaja, *Se je lule që s'humet*, f. 29.

* Shënim: Ru-ba-ee (rubaia) ndryshe quhet edhe tetrastik, katërvargësh që rimojnë vetëm tre prej tyre, vargu I, II dhe IV, i tretë nuk rimon, ndaj quhet tetrastik.

²⁵ E. J. W. Gibb, *A history of Ottoman poetry 1875-1901*, vol. I, London Luzac, Toronto, 1900, f. 88-89.

²⁶ A. Pagliaro, A. Bausani, *La letteratura persiana*, Sansoni-Accademia, Firenze, 1968, f. 319 dhe 326.

Metrika persiane në poezinë e Vexhi Buharasë

*Mbi tulipanët ngjya-ngjyra ky lot i vesës si po ndrin*²⁷. A (17 rrokje)

Ti o shpirt, që u çlirove nga dyshimi i pastërtisë, A (17 rrokje)

Ti, o trup, që u shpëtove dhimbjeve të pleqërisë, A (16 rrokje)

Ti vetë duhet të jesh, si kopshti paradisi, B (13 rrokje)

Aty ku na ndizet flaka me zjarrin e dashurisë.²⁸ A (15 rrokje)

Një arsye tjetër që poeti Buharaja përdor katërvargëshin është se ai gjendet edhe në poezinë shqipe, dhe sidomos në folklorin shqiptar, duke qenë pjesë e sistemit prozodik shqiptar. Të krijuarit me këtë vargëzim nga ana e poetit, i cili ngjason në disa aspekte me rubainë persiane për arsyet që folëm më lart, justifikon faktin e mësipërm, përdorimin qysh herët të katërvargëshit nga poetët shqiptarë. Përdorimin e katrenit nga Buharaja e shohim edhe në poezitë e tjera si: “*O fletëz e Zambakut*”, “*Mbi varr të saj*”, “*Një ditë dhe një natë*”, “*Tri ditë*” dhe në poezinë “*Poeti*” i cili rimon sipas skemës metrike ABBA, ABAB dhe AABB (katrena të tipit heroik).

O fletëz e zambakut, pasqyr e bukurisë! A (14 rrokje)

Ç’të duhet ves’ e Majit? Dy lot prej zemrës sime B (14 rrokje)

Në gjitë e tu mëshihi për jetë si kujtime B (14 rrokje)

*Si mall të dashurisë...*²⁹ A (7 rrokje)

Me sytë e mi mbufatur mbi varre të ‘saj qëndrova A (14 rrokje)

Në der’ ku lyhet jeta me lot, me gjak, me vrerë B (14 rrokje)

Trokita mos ma nxirrin ta shihja edhe një herë B (14 rrokje)

*Atë që dashurova*³⁰ A (7 rrokje)

Ajo që vihet re tjetër në poezitë “*Një ditë dhe një natë*”, “*Tri ditë*”, “*Se je lule që s’humbet*” apo “*Poeti*” është se kemi përzierjen e llojeve poetike. Buharaja përdor përveç katrenit klasik (katërvargëshit) edhe modelet poetike perso-arabe “masnavinë” dhe “kasidenë”, të cilat do t’i analizojmë më poshtë. Ndaj dukuria e përzierjes së zhanreve të ndryshme

²⁷ D. Shaplo, *Antologjia e poezisë persiane*, Fondacioni kulturor iranien “Said Shiraz”, Tiranë, 2011, f. 64.

²⁸ Xhelalu-Din-Rumi-U, *Shkëndijë hyjnore: Distikë dhe Rubai*, SHB “Mendimi i lirë” 1999, f. 42.

²⁹ Shih V. Buharaja, *O fletëz e Zambakut; Vexhi Buharaja: njeriu, poeti, dijetari 1920-1987*, A. Kondo, f. 32.

³⁰ Shih V. Buharaja, *Mbi varr të saj*, f. 33.

brenda një poeme nuk tregon një risi nga ana e Buharasë, pasi këtë e shohim edhe në letërsinë persiane. Kjo dëshmon për një tjetër ndikim të kësaj letërsie në krijimet e Buharasë. Lidhur me këtë fakt flet studiuesi Sutton i cili thotë se, “rubaia është përdorur në format e vargëzimit si: kaside në rastin e poetit Farrukhi, mussamat te Manuchihri dhe qita (kat’e) te Hamadani”³¹. Një tjetër lloj poetik me burim oriental, që Buharaja përdori në poezitë e tij, është *kaside-ja*, një formë me origjinë të pastër arabe³². Sipas këtij modeli poetik është ndërtuar poezia “Poeti”, dhe kjo shihet së pari nga subjekti që trajton ajo, një poezi e tipit lavdërues, që poeti ia dedikon një prej poetëve të shquar shqiptarë, Lasgush Poradecit. Kaside do të thotë diçka e menduar ose qëllim i veçantë. Në poezi ajo i afrohet një poeme, e cila mishërohet me një domethënie të veçantë. Pjesa qendrore e kasidesë është eulogjia. Poeti anon drejt një lloji të epikës dhe ajo shihet si një mburrje e një heroi epik që paraqitet në kaside. Sepse në eulogji poeti kompozon poemën e tij me shijen e një mburrjeje. Prandaj, karakteristikat metafizike të heroit epik dhe hiperbolat natyrore në epikë janë nganjëherë të ruajtura³³. Megjithatë kaside ka trajtuar edhe subjekte të tjera, siç lidhen me ngjarjet e Qerbelasë. Sipas studiuses Glassen, ngjarja e Qerbelasë ka pasur një impakt të madh te Shiitët dhe në zhvillimin e Tazijatit.

Poetët shiitë janë ndër të stimuluar që të shkruajnë kaside dhe mersije. Disa prej tyre shohin në këtë ngjarje dramën e Hysenit dhe familjes së tij³⁴. Qasideh (elegji) ka një strukturë të ngjashme me gazelin, por ndryshe nga ai trajton një temë të përpiktë, siç mund të jetë histori, një skenë përshkrimi apo adhurim ndaj një personi.

Nuk kufizohet në gjatësi, dhe kaside është poema tipike e poetit Khaqan³⁵.

Këtij elementi strukturor (subjektit-lavdërues) i bashkëngjiten edhe të tjera elemente prozodike të cilat janë unike për vetë llojin poetik të kasidesë, dhe që evidentohen qartazi në këtë poezi. Megjithatë së pari duhet të kuptojmë esencën e kaside-së, dhe për këtë na vijnë në ndihmë

³¹ *Po aty*, f. 637.

³² Shih J. Rypka, f. 94.

³³ A. Tamimdari, *Historia e letërsisë perse: llojet letrare, periudhat, shkollat, stilet*, Fondacioni kulturor “Saadi Shirazi”, Tiranë, 2008, f. 178 dhe 180.

³⁴ E. Glassen, *Muharram ceremonies in the Istabul at the end of the XIX-th and the beginning of the XX-th century*, Les Iraniens, d’Istanbul, IFEA/IFRI, Istanbul-Teheran, 1993, f. 118.

³⁵ M. Malek, *Persian poetry; an introduction*, Qershor, 2008, f. 1.

studime të ndryshme lidhur me të. Kaside* (Ka-see-deh) ose idil i ngjason gazelit (ghuzel) veçse ndryshe nga ai përbëhet nga më shumë se 12 distikë*.

Subjekti që trajton kaside është e karakterit lavdërues, moralizues, saterik etj.

Pjesë strukturore e kaside-së është *matla* (mutla) e cila konsiston në dy ose tre distikë që rimojnë njëri me tjetrin³⁶. Në poemën e ndërtuar sipas këtij modeli gjenden zakonisht dy ose tre matla (matla's) ose siç quhen distikë të rimueshëm (dyvargësh që rimojnë njëri me tjetrin) përveç distikëve që hapin poemën. Ato mund të shërbejnë si parathënie, ose gjatë zhvillimit të poemës mund të thyejnë një sekuencë të gjatë fjalie në varg (non-musarra') duke i hapur rrugë një paragrafi të ri. Është e lejueshme që në kaside të ripërsëritet e njëjta fjalë e rimueshme me të njëjtin kuptim, me kusht që kjo të gjendet në mes të distikut të shtatë. Gjithashtu kemi edhe futjen e gazeleve në kaside³⁷. Kaside përbëhet së paku nga 15 distikë, ndërsa për të tjerët kufizohet nga 7 ose 10 distikë me modelin rimik aa, ba, ca etj., forma e kaside-s është poema me përmbajtje, saterike, fetare, panegjerike, didaktike ose elegjiake. Ato zakonisht kanë një hyrje të pastër lirike, që quhet *nasib**, ndërsa kur përzihet me eroticizëm, quhet *tashbib*

* Shënim: Termi qasida buron nga "*qasada*" që do të thotë "*kam në mend*" ose "*paracaktoj*" ose *qëllim*. Për këtë shih "*Encyclopedia of arabic literature*" edited by Julie Scott Meisami and Paul Starkey, Vol. 2, Published by Routledge, Taylor and Francis Group, New York, 1998, f. 630. Po ashtu fakt është se kasideja ka qenë zhanri kryesor i letërsisë në religjion brenda dhe jashtë Iranit gjatë tre shekujve. Ajo ka qenë e pranishme deri para viteve të shekullit të 13-të, por kompozuesit më të mëdhenj të saj kanë jetuar në shekullin e 10-të dhe 12-të. Në kaside hemistiku (gjysmë vija) i parë i vargut të rimës së parë shkon me hemistikun e vargut të rimës së dytë. Citimi është marrë nga *Historia e letërsisë perse*, A. Tamimdari, f. 178 dhe 180.

* Shënim: Vargjet (distikët) në kaside fillojnë nga 17-20 vargje; natyrisht ka edhe kaside me 15 vargje. Ky pakësim ose rritje e numrit të vargjeve varet nga lënda e kasidesë, aftësia e poetit dhe ka të bëjë me zërin e njehsimit prozodik si edhe me strukturën e saj muzikore si radif dhe rimën. Kështu që kasidetë perse, të cilat pajtohen me fitore kanë nga 170 vargje. Citimi është marrë nga *Historia e letërsisë perse*, A. Tamimdari, f. 179.

³⁶ F. Gladwin, *Dissertations on Rhetoric, prosody and rhyme of the Persians*, Calcutta Printed, 1801, f. 2.

³⁷ E. J. W. Gibb, *A history of Ottoman poetry 1875-1901*, vol. I, London Luzac, Toronto, 1900, f. 85.

* Shënim: Sipas poetit arab Ibn Qutayba, termi *Nasib* ose siç quhet ndryshe prelude nostalgjik si element strukturor i kaside ka të bëjë me vajtimin e poetit ndaj

ose *taghazzul*. Përfaqësuesit kryesorë të kasidesë janë Rudaki, Farrukhi, Unsuri, Khaqani etj.³⁸ *Më ranë dhëmbët një nga një dhe i kujtoj tani, kur zbardhnin si thelpinj të bardhë, si drit' e farfuri / ndriçonin larë në ergjend si perlë e si koral, mos ishin yje në agim a, ndofta, pika shi?*³⁹ *Erërat e verës frynin mbi të njëra pas tjetrë, dhe era tërhiqte pas vetes rrobën e saj duke shuar gjurmët (ab).*⁴⁰

Ndërkaq, studiuesja Annemaria Schimmel si pjesë strukturore të kaside sheh edhe figuracionin, që sipas saj, “hiperbola është figura më e guximshme që evidentohet këtu, si një nga imazhet më të fuqishme dhe më madhështore”. Ndërkohë që pohon edhe faktin se “në pjesën e fundit ajo përmban një varg anaforash që fillojnë me fjalët *ta...ta* (aq e gjatë sa). Disa kaside - pohon Schimmel - janë ndërtuar si *munazara*, të cilat kanë të bëjnë me krahasimin e dy gjërave të kundërta, për sa i përket formës dhe përmbajtjes”⁴¹.

Përkufizimet e mësipërme për kasidenë nga studiues të huaj na hapin rrugën për një analizë të atyre poezive që poeti Buharaja ka tentuar t'i shkruajë me këtë model poetik. Dhe është pikërisht poema, “Poeti” që është shkruar në llojin poetik të kasidesë, edhe pse kemi praninë e një zhanri tjetër poetik, atë të katrenit, që e mbyll atë. Në këtë poemë duket qartë aftësia poetike e Vexhi Buharasë për ta sjellë kasidenë në formën e saj origjinale, ndryshe nga rubaia që pamë më sipër. Ai ka ruajtur disa prej elementeve strukturore të këtij modeli poetik në poemë, siç është matla (3 të tilla), subjekti, prania e anaforave (redifit) dhe figurës së hiperbolës, apo edhe ndërtimi i saj si *munazara* (krahasimi i gjërave të kundërta) etj. Por ndërkohë i vetmi element strukturor, që poeti nuk ka ruajtur në këtë poemë, është skema metrike e kasidesë aa, ba, ca, da, pasi ajo ndërtohet sipas skemës rimike ba, ca, da, që na ngjason me zhanrin poetik *qita*

dezertimit nga kampi i së dashurës. Këtë e shohim kryesisht në kasidet arabo-perse (shënimi im). Për referencën e mësipërme shih, J. A. Cuddon, *A dictionary of literary terms and literary theory*, Vol. 5, UK, 2013, f. 578.

³⁸ J. Rypka, *History of iranian literature* D. Reidel Publishing Company, Dordrecht-Holland, 1968, f. 94.

³⁹ Pjesë e shkëputur nga poezia e Rudakiut *Si shesh m'u bë zemra*, f. 57 marrë nga libri “Antologjia e poezisë persiane, Botimi II, Tiranë, 2011. Siç shihet vargjet rimojnë sipas skemës metrike të kaside aa, ba etj.

⁴⁰ Pjesë nga Abid Ibn Abras marrë nga “Classical Arabic Literature” A library of Arabic Literature, Anthology selected and translated by Geert Jan Van Gelder, University New York Press, 2013, New York-London, f. 3.

⁴¹ *Po aty*, f. 24-25.

(*kit'ah*)*. Kat'e është strukturë e poezisë, vargu i së cilës nuk shoqërohet me rimë, ndërsa tri vargjet e tjera kanë rimë të njëjtë. Kat'e ka kuptimin e pjesës ose të copës dhe këtë emër e ka marrë, sepse kjo pjesë e poezisë sillet në mesin e kasidesë. Konceptet që, më së shumti, përdoren në këtë lloj poezie, janë konceptet morale, didaktike, lavdëruese dhe elegjiake. Edhe sipas studiuesit Jan Rypka, "qita (kita) kufizohet nga skema metrike ba, ca, da në të cilën mungon vargu hapës që rimon sipas skemës aa, që gjendet në modelet poetike kaside dhe gazel"⁴². *Një shkëlqim i perëndishëm që s'ka shembull e të ngjarë (b) / të pushtoj ty, zog' i dheut, që ke krah' e tinguj qielli (a) / mu në zemër të dha frymë, ndënë buz' margaritarë (c) / ndaj ia nise për të thurrur atë këng' nën rreze dielli (a).*⁴³ Këtë e shohim edhe te poezia "Përpara Tomorrit" e shkruar në modelin poetik masnavi: "*dhe kjo dritë dhe kjo flakë, që po ndez një qiell floriri (b) / që po qesh nga maj e malit si një diell ndaj të gdhirë (a) / zog i shpirtit tundi krahët mbi Tomorritin fluturoi (c) / shpuz e mallit po valvitet, trete helmin, ligjëro (a) / dhe këndo posi bilbili me aq mall e drithërimë (d) / gjer në fund të ditës sime (a).*"* Për të vërtetuar ato ç'ka thamë më sipër lidhur me elementet strukturore të kasidesë, që poeti i ruan në poemën e tij, le të analizojmë vargjet e mëposhtme:

Që ka aqë dhimbje shpirti sa dhe lotët **e të mjerit**, a
Aqë gaze,...aq' dëshira...sa dhe valet **e liqerit**, a (1 matla) (strofa e parë)

Që shuan prush- e flakë zemrash që dremijn' **në fund të gjumit**, a
Që ka ngjyrat e agimit, **qetësin' e Shëndnaumit** a (2 matla) (strofa e dytë)

Përmes flakëve të zjarrit gjejnë fluturat **dashurinë**, a

* Shënim: Sipas al-muxham, në qoftë se nuk ka fragment të mësuar përmedësh të Matla-s ajo do të jetë në formën e kit'ah (fragmentit). Për këtë shih *Historia e letërsisë perse*, Ahmed Tamimdari, f. 179.

⁴² Shih *History of iranian literature* D. Reidel Publishing Company, Dordrecht-Holland, 1968, f. 95.

⁴³ V. Buharaja, *Poeti*, f. 47, marrë nga libri i A. Kondo, *Vexhi Buharaja: njeriu, poeti, dijetari 1920-1987*.

Siç shihet vargjet rimojnë sipas skemës rimike ba, ca, etj.

* Shënim: Siç shihet kat'e kjo pjesë e poezisë qëndron në mesin e masnavisë "Përpara Tomorrit", në të cilën vargjet e tjera rimojnë sipas skemës aa, bb, cc, dd, vetëm këto vargje rimojnë sipas skemës së gjinisë kat'e (qitah). Vargjet janë shkëputur nga poezia "Përpara Tomorrit", f. 40.

Mes lëkundjeve të detit gjejnë lundrat **lumturinë**...a (3 matla) (strofa e tretë)

Sikundër shihet poeti ruan në këto vargje tiparin strukturor të kaside-s, matla, që në skemën origjinale të saj gjenden dy ose tre matla. Ndërkohë që në vargjet e poemës “Poeti” kemi praninë e radifit apo refrenit persian, i cili zëvendësohet nga figura e anaforës. Termi anaforë buron nga greq. e vj. “ana” pas, kthim pas “fora” “mbartje” d.m.th. “përsëritje” (shënimi im., anafora përdoret në disa kuptime) ...në retorikë ajo është një figurë e përsëritjes së një fjale në fillim të fjalive të njëpasnjëshme, dhe në ligjërime, kjo figurë përdoret për të na kthyer te diçka që është përmendur më parë në tekst⁴⁴.

Ndaj funksioni i saj është për t’i dhënë forcë shprehjes poetike dhe ritëm vargut, ndërkohë që kemi disa lloje anaforash, si gramatikore ashtu edhe leksikore. Anafora mund të jenë përemrat pyetës, dëftorë, vetorë, emrat, mbiemrat, foljet si edhe ndajfoljet. Atëherë redifi persian në poemën “Poeti” krijohet nga anaforat si:

Që ka **aqë dhëmbje** shpirti **sa dhe lotët** e të mjerit,
Aqë gaze,.....**aq’ dëshira**....**sa dhe valët** e liqerit (redif persian-
 anafora lidhore aqë-aqë)

Që shuan prush-e flakë zemrash që dremijn’ në fund të gjumit,
Që ka ngjyrat e agimit, qetësin’e Shëndnaumit, (refid persian-
 anafora përemërore që... që)

Përmes flakëve të zjarrit **gjejnë fluturat** dashurinë, (anafora
 përmes... mes)

Mes lëkundjeve të detit **gjejnë lundrat lumturinë**... (anafora foljore
 gjejnë... gjejnë)

Siç shohim, vargjet e mësipërme të kaside-s, “Poeti”, janë ndërtuar edhe si munazara, koncept që përfshin në vetvete krahasimin e dy gjërave të kundërta, p.sh., “mes flakëve të zjarrit fluturat gjejnë dashurinë / mes lëkundjeve të detit lundrat gjejnë lumturinë”. Antitezat që krijohen këtu janë **zjarri/deti** dhe **fluturat/lundrat**, ndërkohë që kemi edhe shembuj të tjerë si: **dhëmbje/gaze**, **lotët e të mjerit/valët e liqerit** që i shohim në

⁴⁴ A. Çepani, *Anafora në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2015, f. 18 dhe 24.

strofën e parë të poemës apo *syperlotur/zemërqeshur* ...që nga fund i vuajtjes tënde dhe *këngëtar në drita gazi / durimtar në varfëri, përmes dhëmbjeve të moçme / buzëqesh si djal' i ri, posi shpata-e ylberit / mes zemërimeve të motit* etj. Ndaj antiteza (nga gr. antithesis - kundërvendosje) është një figurë e përbërë prej dy njësive kuptimore, lidhja e të cilave bëhet me kundërvënie. Kundërvënia mund të bëhet në nivel të fjalëve, në nivel sintaksor dhe në atë kuptimor⁴⁵. Sakaq mund të flasim edhe për një tjetër tipar strukturor të kaside-së, që ka të bëjë me figurën e hiperbolës, e cila luan një rol të rëndësishëm në krijimin e ngarkesës emocionale, që e përshkuan poemën e Buharasë nga fillimi deri në fund. Ndërtimi i figurës së hiperbolës ose teprimit shpesh është një proces i tërë poetik.

Brenda mund të shtrihen imazhe poetike të ndërtuara nga figura të tjera shpesh po aq të fuqishme, mirëpo që i nënshtrohen qëllimit të rritjes tejmasë të asaj që duam ta shprehim me poezinë⁴⁶. Ndaj për studiuesin Rrahmani, "hiperbola" (vjen nga gr. hiper-ballein - stërmadhim) sikur edhe antiteza që në vete mban idenë e një krahasimi të mundshëm, hiperbola nënkupton një krahasim në raport me të cilin bën stërmadhimin, na e jep një send, një kuptim, shumë më të madh sa që realisht është⁴⁷. Atmosfera hiperbolike, që krijohet në poemë shprehet përmes vargjeve si: *një shkëlqim i perëndishëm që s'ka shembull e të ngjarë / të pushtoj ty zog i dheut*, që ke krah' e tinguj qielli, ndënë buzë margaritarë / ty të pashë, o zog i këngës, duke hipur ngadalë / sipër rrezesh të mëngjesit që fal supresa etj.*⁴⁸ Përmes kësaj figure Buharaja arrin të realizojë qëllimin e tij, adhurimin deri në pafundësi ndaj figurës së poetit Lasgush Poradeci. Përveç llojeve poetike si kaside, fard apo rubai, poeti Buharaja në poezitë e tij përdor edhe formën poetike mathnavi (masnavi). Me këtë lloj poetik janë ndërtuar poezitë si: "Çudit e fshatit tim", "Dua të jem flutur", "Eja të vemi gjer te burimi", "Një ditë dhe një natë", "Lot i nënës", "Tri ditë" dhe "Përpara Tomorrit". Pavarësisht kësaj, brenda një poezi mund të gjejmë dy lloje poetike, fakt është edhe për ato poezi, të cilat janë ndërtuar sipas

⁴⁵ Z. Rrahmani, *Teoria e letërsisë*, Prishtinë, 1996, f. 88.

⁴⁶ Z. Rrahmani, *Arti i poezisë*, SHB Faik Konica, Prishtinë, 2001, f. 108.

* Shënim: Shih Cuddon f. 346 për figurën e hiperbolës. Sipas Cuddon, hiperbola si figurë e ligjëratës, ka të bëjë me një ekzagjerim, me një theksim të fortë në fjalë.

⁴⁷ Z. Rrahmani, *Teoria e letërsisë*, Prishtinë, 1996, f. 89.

* Shënim: Zogu i dheut është vetë poeti Lasgush Poradeci, ku poeti Vexhi Buharaj e vesh atë me një lloj misticizmi hyjnor duke e quajtur edhe një shkëlqim të perëndishëm që s'ka të ngjarë me asnjë.

⁴⁸ Shih V. Buharaja, *Poeti*, f. 47.

modelit poetik masnavi. Masnavitë, që ndryshe quhen edhe bashkëdyzim ose çifte, janë një lloj poezie ku rryma e të gjitha vargjeve është e njëjtë. Por në çdo dy rreshta ka një rrymë të pavarur dhe pikërisht për këtë arsye edhe quhen masnavi ose “dyshe”. Vlen të theksohet se numri i dy vargjeve nuk është i kufizuar dhe për këtë arsye masnavitë janë një kornizë ose formë e përshtatshme për tregime, legjenda dhe epope të ndryshme⁴⁹.

Etimologjikisht, *mathnavi** buron nga fjala arabe *mathna* “dy për dy” ekuivalente e fjalës perse “*du-bayti*” (dubajt) që nënkupton këngë⁵⁰. Emri i Mevlanas dhe emri i masnavive janë fjalë të pandashme. Në ish Perandorinë Osmane ato quheshin “mesnevi” dhe në persishte “mathnavi”. Ndërsa studiuesit e Perëndimit, masnavitë i quajnë “odet e lindjes”. Ky ndoshta është termi më i afërt për të paraqitur terminologjikisht kuptimin e masnavive, sepse ato janë njëherësh poezi, këngë, filozofi, urtësi, predikim, porosi, këshillë, rit, besim e fe.⁵¹ Karakteristikë tjetër e masnavisë është se çdo gjysmëvarg (misra) përmban 11 rrokje.⁵² Për studiuesin Elwell- Sutton, kjo gjë lidhet me veprat e shkruara në masnavi të periudhës Pahlavi, ku vargu me 11 rrokje ishte një normë për këtë formë poetike.⁵³ Fakt është se poetët shqiptarë të ditëve të sotme kanë një tendencë që të shkruajnë masnavi (distikë) në një numër të kufizuar vargjesh, por edhe që ato përbëhen nga 12 deri 15 rrokje. Një gjë të tillë e shohim edhe te Buharaja, i cili përpiqet të shkruajë masnavi të shkurtra. Masnavi është poema tipike e Firdeusit, Nezamit apo e Rumiut.⁵⁴ Veç ty, moj të dua, o imi **gëzim** / Veç teje gjë tjetër nuk do shpirti **im!** / Në vend

⁴⁹ A. Tamimdari, *Historia e letërsisë perse: llojet letrare, periudhat, shkollat, stilet*, Fondacioni kulturor “Saadi Shirazi”, Tiranë, 2008, f. 208-209.

* Shënim: *Mathnavi* ose *Mathnaviyat* (shumës), një fakt historik që lidhet me këtë formë poetike është që tipi më i vjetër i poemës së shkruar në masnavi është “Kopshti i së vërtetës” *Hadiqat ul-haqiqah*, i Hakim Sana-it. Ndaj kjo formë u zhvillua më shumë në shekullin e 11-të, si shprehje e një poeme heroike, romantike apo etiko-didaktike. Shih Bo Utas, “*The literary expession of persian Sufism*”, Scripta Instituti Donneriani, Aboensis 5, Stockholm, 1970, f. 211.

⁵⁰ C. E. Bosworth, E. Van Donzel, W. P. Heinrichs, Ch. Pellat, *The encyclopaedia of islam*, Vol. VI, E. J. Brill. Leiden, 1989, f. 831.

⁵¹ R. Karami, “*Masnavitë*”-odet e Lindjes, Perla, revistë shkencore-kulturore, nr. 3, Tiranë, 2007, f. 6.

⁵² O. Harassan, *A manual of classical persian prosody*, Wiesbaden, 1982, f. 138.

⁵³ L. P. Elwell-Sutton, *The persian metres*, Cambridge University Press, London, 1976, f. 245.

⁵⁴ M. Malek, *Persian poetry; an introduction*, Qershor, 2008, f. 1.

*prapë ia ktheva këtë **dashuri** / por ja se si flokët m'i shkuli **ai**.⁵⁵ O Nizam!
Ti hidh sytë, kopshtin a e **vështron**? / Nga trëndafili del gjëmbi dhe gjëmbi
të **shpon** / Qejf-parajsa çoi Bahramin mu në ferr të **zi** / Veç dy ditë
gënjeshtare pat' në **mbretëri**.⁵⁶*

O shpirt e diell, ti dritë që rron te **ne** / që jetën lind dhe botën bën të **re!** Shpirti buron nga njerëzit e **dikurshëm** / që vinë si valë dhe bëhen të **padukshëm**.⁵⁷ Ajo që vihet re është se poeti Vexhi Buharaja përpiket të shkruajë masnavi të shkurtra, ndryshe nga poetët e njohur persianë, të cilët shkruan masnavia, numri i vargjeve të cilave shkonte deri në 75.000. Në poezitë e llojit masnavia të Vexhi Buharasë, numri i vargjeve të distikëve qëndron mes kufirit 15-10 distikë, ku shihet qartë tendenca gjithnjë e në rritje për zvogëlimin e numrit të tyre, duke na dhënë idenë e poemave më të shkurtra.

Megjithatë, poeti Buharaja është përpjekur që të ruajë strukturën metrike të masnavisë në disa poezi më shumë, në disa të tjera më pak. Por elementet strukturore të masnavisë që janë ruajtur në të gjitha poezitë e modelit masnavi të Buharasë, janë skema metrike *aa*, *bb*, *cc*, *dd* dhe *refrenin* (apo siç njihet në poezinë persiane si, *redifi*). P.sh.:

Dua të jem flutur të puth **ngadalë** a
Detin e livadhin si anij' mbi **valë**⁵⁸ a (skema rimike aa)

Të mshihem në fletë, të mshihem në **hije** b
Të dëgjoj e heshtur këngë **dashurie**⁵⁹ b (skema rimike bb)

Përtype dhëmbjen, o vash' **e lotit!** a
Dhe shpirtin zbardhe, se nat' **e motit**⁶⁰ a (skema rimike aa)

⁵⁵ Firdeusiu, *Shah-Name- (Fragmente të zgjedhura)*, Shtëpia botuese dhe Studio letrare, Tiranë, 2010, f. 412.

⁵⁶ Nizami, *Të shtatë pallatet, Antologjia e poezisë persiane*, Botimi II-të, Tiranë, 2011, f. 128.

⁵⁷ M. Xh. Rumi, "Omari dhe Lahutari", *Poezi të zgjedhura nga Masnavi Ma'navi*, Tiranë, 2007, f. 35.

⁵⁸ V. Buharaja, "Dua të jem flutur", marrë nga libri i A. Kondo, V. Buharaja, *njeriu, poeti, dijetari 1920-1987*, f. 36.

⁵⁹ *Po aty*, f. 36.

⁶⁰ V. Buharaja, "Eja të vemi gjer te burimi", marrë nga libri i A. Kondo, V. Buharaja, *njeriu, poeti, dijetari 1920-1987*, f. 38.

Që hapej, tundej në val' e shkumë,
Që qeshte embël, me gaz të shumë (redifi-*që hapej-që qeshte*)⁶¹

Asaj kënge ziliqare që të mek, të ngashëron
Asaj kënge që pjell shpresa... lind dëshira dhe shtron mall (redifi-*asaj kenge-asaj kënge*)⁶²

Një karakteristikë tjetër që hasim te modeli poetik mathnavi (masnavi) është se ajo kufizohet nga 10-11 rrokje për varg. Megjithatë, masnavitë e poetëve persianë të shekujve 11, 12 e 13-të, kufizoheshin nga 10 deri në 17 rrokje për varg, kjo në varësi të tipit të poemës që mund të ishte e llojit narrativ, e cila e lejonte një gjatësi të tillë të vargut. Një gjë të tillë e shohim edhe në disa poezi të Vexhi Buharasë, ku kemi distikë që kufizohen nga 10-11 rrokje deri në 12-13-14-15-16-17-18 rrokje. Siç shihet në ato poezi ku distikët kufizohen nga 10-11 rrokje, poeti është përpjekur të ruajë tiparin strukturor të masnavisë, nga fillimi deri në fund, dhe ta sjellë atë në mënyrë origjinale. Këtë element strukturor ai e ruan në poezitë “Eja vemi gjer te burimi” dhe “Tri ditë” ...por duhet thënë se disa vargje kufizohen edhe në 8-9 rrokje.

Do thot': “Po deshët er' amshimi, (9 rrokje)
 Eja të vemi gjer te burimi!...”⁶³ (10 rrokje)

Vargu persian i cili ndahet në gjysmëvargje (hemistikë) përmban dhe një numër të caktuar këmbësh. Në rastin e modelit poetik masnavia, për të cilën po flasim, nisur edhe nga gjatësia e pakufizuar e vargut të saj, është e përbërë kryesisht nga 6 këmbë* dhe 8 këmbë. Në poezinë persiane masnavitë kanë qenë të tipit musaddas dhe muthamman.

Masnavi të këtyre tipave gjejmë edhe Buharaja, sidomos në ato vargje që kufizohen nga 12 deri në 16 rrokje. Megjithatë këta distikë alternohen edhe me të tjerë, metrat e të cilëve përmbajnë 5 (pentametër) dhe 7 këmbë (heptametër). Kështu le t'u referohemi shembujve të mëposhtëm:

⁶¹ V. Buharaja, “Tri ditë”, marrë nga libri i A. Kondo, *V. Buharaja, njeriu, poeti, dijetari 1920-1987*, f. 45.

⁶² V. Buharaja, “Çudit e fshatit tim”, marrë nga libri i A. Kondo, *V. Buharaja, njeriu, poeti, dijetari 1920-1987*, f. 35.

⁶³ *Po aty*, f. 38.

* Shënim: Hekzametri (6 këmbë) përdoret në metrin Ramal që kryesisht e gjejmë në masnavi.

Metrika persiane në poezinë e Vexhi Buharasë

Ty t'u shua yll i jetës, mua yll' i shpresës sime..

Mirpo unë do valvitem brenda botës, vetes time⁶⁴ (8 këmbë - oktametër)

Dua të jem flutur, të gjej dritën time..

Dhe si yll që dridhet nëpër përvëlime⁶⁵ (6 këmbë-hekzametër)

Si përfundim mund të themi se vlerat e këtyre modeleve poetike si: fard, rubaia, kaside, kat'e (kita) dhe masnavia me origjinë orientale, në poezitë e Vexhi Buharasë, qëndrojnë jo vetëm te tematika, por edhe te artikulimi i tyre poetik. Çdonjëra prej këtyre formave poetike, sipas të cilave ndërtohen disa prej poezive apo poemave të Buharasë, janë një sintezë e mendimeve të tij filozofike, mistike, erotike, si edhe e gjendjes së tij shpirtërore.

Në analizën që u bëmë poezive të poetit Vexhi Buharaja, pamë një përpjekje të tij për t'i risjellë këto modele teknike sa më origjinale në formë dhe përmbajtje, edhe pse nuk mungon origjinaliteti i tij krijues, duke na treguar kështu edhe njëherë ndikimin e madh, që ka pasur letërsia orientale dhe veçanërisht ajo persiane në krijimtarinë e tij si krijues, dhe që vazhdon të ketë edhe sot në poezinë shqipe.

BIBLIOGRAFI

- Bosworth, C.E., Van Donzel, E., Heinrichs, W. P., Pellat, Ch., *The encyclopaedia of islam*, Vol. VI, E.J Brill. Leiden, 1989.
- Bulo, J., *Vexhi buharaja na sjell një epos madhështor të një epoke të largët*, Republika, 2010/ 98-123, Tiranë.
- Cuddon, A., *The penguin dictionary of literary terms and literary theory*, Penguin group, England, 1999.
- Çepani, A., *Anafora në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2015.
- Gibb, E. J. W., *A history of Ottoman poetry 1875-1901*, vol. 1, London Luzac, Toronto, 1900.
- Gladwin, F., *Dissertations on Rhetoric, prosody and rhyme of the Persians*, Calcutta Printed, 1801.

⁶⁴ Shih poezinë "Lot i nënës", f. 44.

⁶⁵ Shih poezinë "Dua të jem flutur", f. 36.

- Glassen, E., *Muharram ceremonies in the Istabul at the end of the XIX-th and the beginning of the XX-th century*, Les Iraniens, d'Istanbul, IFEA/IFRI, Istanbul-Teheran, 1993.
- Harassan, O., *A manual of classical persian prosody*, Wiesbaden, 1982.
- Hima, Y., *Vexhi Buharaja pa mite e mjegull* AIITC, Tiranë, 2008.
- Karami, R., "Masnavitë" - odet e Lindjes, "Perla", revistë shkencore-kulturore, nr. 3, Tiranë, 2007.
- Kondo, A., *Vexhi Buharaja njeriu, poeti, dijetari 1920-1987*, "Uegen", Berat, 1995.
- Loraine, M.B., *Dissertations of prosody and rhyme in classical Arabic and persian*, Seattle, USA, 1973.
- Malek, M., *Persian poetry; an introduction*, Qershor, 2008.
- Matini, Y., *The different aspects of Islamic culture*, Culture and Learning Islam, Vol. 5, Unesco 2003.
- Pagliaro, A., Bausani, A., *La letteratura persiana*, Sansoni-Accademia, Firenze, 1968.
- Rypka, J., *History of iranian literature*, D. Reidel Publishing Company, Dordrecht-Holland, 1968.
- Rahmani, Z., *Arti i poezisë*, SHB Faik Konica, Prishtinë, 2001.
- Rahmani, Z., *Teoria e letërsisë*, Prishtinë, 1996.
- Schimmel, A., *A two colored brocade, the imagery of persian poetry*, University of North Carolina Press, Chapell Hill and London, 1992.
- Shaplo, D., *Antologjia e poezisë persiane*, Fondacioni kulturor iranian "Said Shiraz", Tiranë, 2011.
- Shatro, B., *Vexhi Buharaja, mistike dhe logos në kulturën shqiptare*, Art dhe Trashëgimi, 2011/1, Berat.
- Shuterqi, Dh., *Metrika shqipe për shkollat e mesme dhe të nalta*, Enti i botimeve të teksteve, Prishtinë, 1968.
- Tamimdari, A., *Historia e letërsisë perse: llojet letrare, periudhat, shkollat, stilet*, Fondacioni kulturor "Saadi Shirazi", Tiranë, 2008.
- Xhelalu-Din-Rumi-U, *Shkëndijë hyjnore: Distikë dhe Rubai*, SHB "Mendimi i lirë", 1999.
- Zohar, I., *Papers in historical poetics*, Tel Aviv, 1978.